



SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti për nevoja të Shoqërisë Rajonale UK Sarandë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karburante
09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 759 752(shtate milione e shtateqind e pesedhjetë e nente mije e shtateqind e pesedhjetë e dy) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e fondit limit që prokurohet.

2.2.2 Kopje të certifikuarave të bilanceve për dy vitet e fundit **2022 dhe 2023**, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në të dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20 % të vlerës së fondit të limitit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerë sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per proceduren e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1(një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit, ne nje distance te pershtatshme, jo me shume se 10(dhjete) km nga Zyrat Qendrore te Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a., vërtetuar kjo me kontratë noteriale qeraje ,akt pronësie, ose adresa e stacionit te tregëtimit të jete e pasqyruar në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme, mbeshtetet me teper ne nje llogjike te qarte dhe te thjeshte, e cila konsiston ne faktin qe ; automjeti per t'u furnizuar me karburant, nuk ka pse te pershkoje nje distance , po themi, me teper se 10 km(vajtje-ardhje 20 km), duke humbur keshtu kohe dhe gjithashtu duke rritur ne menyre artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit dhe pervec kesaj, meqenese shumica dermuese e mjeteve dhe automjeteve i perkasin dhe punojne kryesisht ne territorin e njesise Sarande, do te ishte me e llogjikshme qe, mjetet e tjera, te pakta ne numer, qe i'u perkasin njesive te tjera, te vinin per t'u furnizuar ne kete stacion karburanti se sa, mjetet e njesise Sarande te shkonin dhe te furnizoheshin, p.sh, ne Konispol, qe eshte rreth 50 km larg nga Saranda.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant me pakicë me shërbim 24 orë, me karta elektronike te personalizuar me targat e automjeteve te autoritetit kontraktor
- Subjekti duhet të deklarojë se kartat elektronike duhet të jetë pa skadencë dhe të jene te perdorshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimime pakicë të lëndëve djegëse(lëshuar nga Autoriteti Vendor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Dhe

Bazuar ne Vendim 970 date 2.12.2015 ” Per prcaktimin e procedurave dhe te kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj”, Kreu II, pika

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) *Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EWC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diezel”.

Specifikimet teknike të Gazoil 10 ppm sipas standartit SSH EN 590:2022

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës ^a (Shiko paragrafin 2 Rekomandimet e detyrueshme)
		Minimale	Maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165 EN 15195
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675

				EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë^d	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit^e	mg/kg	-	50,0 (deri 31-12-2008)	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
			10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662^g
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
(FAME) Përmbajtja e esterit metalik me acid yndyror^h	%(V/V)	-	7,0	EN 14078
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
	h	20	-	EN 15751
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi^{k, i}				EN ISO 3405
distilati që vlon në 250°C, %(V/V)	%(V/V)		< 65	
distilati që vlon në 350 °C, %(V/V)	%(V/V)	85		

distilati që vlon në 95 % (V/V)	°C		360	
--	----	--	------------	--

Sasia dhe grafiket e levrimit

Sasia do te percaktohet ne varesi te cmimit te blerjes

Afatet e levrimit

Afati i levrimit do te jete 12 muaj qe nga data e lidhjes se kontrates.

Menyra e levrimit:

-Bazuar ne VKM Nr. 561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", furnizimi me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Per kete operatori ofertues do te paraqese dokumentacion se disponon paisjet per ofrimin e ketij sherbimi.

-Operatori ekonomik duhet te garantoje furnizimin 24 ore pa nderprerje.

-Autoriteti kontraktor rezervon te drejten qe, kur e gjykon te nevojshme, te kerkoje kontrollin e cilesise se karburantit. Shpenzimet per kontrollin te perballohen nga opertatori ekonomik.

1	2	3		5
N r	Përshkrimi i mallrave	Sasia ne litra (e pritshme)	Fondi i perllogaritur	Afati i levrimit
	GAZOIL 10 ppm	49 400	7 759 752	12 muaj

Argumentim: Specifikimet teknike jane ndertuar bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"

NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

ALTIN MACI

ALGERT BAJRAMI